

# DIREKTIVA 2010/13/BE E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN

datë 10 mars 2010

për koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose akt administrativ të shteteve anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve të medias audiovizive (Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive)

(version i unifikuar)

(Tekst me rëndësi për ZEE)

## KAPITULLI I

### PËRKUFIZIME

#### *Neni 1*

1. Për qëllime të kësaj Direktive, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Shërbim i medias audiovizive” do të thotë:

(i) një shërbim, siç përkufizohet në nenet 56 dhe 57 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, ku qëllimi kryesor i vetë shërbimit ose i një pjese të shkëputur të tij i përkushtohet ofrimit të programeve për publikun e gjerë, me qëllim informimin, argëtimin ose edukimin, nën përgjegjësinë editoriale të një ofruesi të shërbimit të medias, përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike sipas kuptimit të pikës (a), neni 2, i Direktivës 2002/21/KE.

Ky shërbim i medias audiovizive është një transmetim televiziv, siç përkufizohet në shkronjën (e) të kësaj pike ose një shërbim i medias audiovizive me kërkesë, siç përkufizohet në shkronjën (g) të kësaj pike;

(ii) një komunikim audioviziv tregtar;

(aa) “Shërbim i ofrimit të platformës për shpërndarjen e videove” do të thotë një shërbim, siç përkufizohet në nenet 56 dhe 57 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, ku qëllimi kryesor i vetë shërbimit ose i një pjese të shkëputur të tij ose i një funksioni thelbësor të shërbimit i përkushtohet ofrimit të programeve, videove të krijuara nga publiku, ose të dyja, për publikun e gjerë, ku ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove nuk ka përgjegjësi editoriale, për të informuar, argëtuar ose edukuar, përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike sipas kuptimit të pikës (a), neni 2, i Direktivës 2002/21/KE dhe organizimi i saj përcaktohet nga vetë ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove, qoftë edhe me anë të mjeteve ose algoritmeve automatike, në veçanti duke shfaqur, etiketuar (tagging) dhe renditur (sequencing);

b) “Program” do të thotë një seri imazhesh lëvizëse, të shoqëruar ose jo me zë, që përbëjnë një gjë të vetme, pavarësisht nga sa minuta zgjat, sipas një orari ose katalogu të krijuar nga një ofrues i shërbimit të mediave, përfshirë filmat me metrazh të gjatë, videoklipet, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramet origjinale;

(ba) “Video e krijuar nga publiku” do të thotë një seri imazhesh lëvizëse, të shoqëruara ose jo me zë, që përbëjnë një gjë të vetme, pavarësisht nga sa minuta zgjat, e që është

- krijuar nga një përdorues dhe është ngarkuar në një platformë për shpërndarjen e videove nga vetë ky përdorues ose ndonjë përdorues tjetër;
- (bb) “Vendim editorial” do të thotë një vendim që merret rregullisht për të ushtruar përgjegjësinë editoriale dhe që lidhet me funksionimin e përditshëm të shërbimit të medias audiovizive;
  - c) “Përgjegjësi editoriale” do të thotë ushtrimin e kontrollit efektiv si në përzgjedhjen e programeve ashtu edhe në organizimin e tyre sipas një orari në renditje kronologjike, në rastin e transmetimeve televizive, ose në një katalog, në rastin e shërbimeve të medias audiovizive me kërkesë. Përgjegjësia editoriale jo domosdoshmërisht nënkupton ndonjë përgjegjësi ligjore sipas ligjit kombëtar për përmbajtjen ose shërbimet e ofruara;
  - d) “Ofrues i shërbimit të medias” do të thotë personin fizik ose juridik, i cili ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes audiovizive të shërbimit të medias audiovizive dhe përcakton mënyrën e organizimit të tij;
  - (da) “Ofrues i platformës për shpërndarjen e videove” do të thotë personin fizik ose juridik që ofron një shërbim të platformës për shpërndarjen e videove;
  - e) “Transmetim televiziv” (d.m.th. një shërbim i medias audiovizive lineare) do të thotë një shërbim të medias audiovizive të ofruar nga një ofrues i shërbimit të medias për të parë njëkohësisht programet mbi bazën e një orari programesh;
  - f) “Transmetues” do të thotë një ofrues të shërbimit të medias për transmetimet televizive;
  - g) “Shërbim i medias audiovizive me kërkesë” (d.m.th. një shërbim i medias audiovizive jo-lineare) do të thotë një shërbim të medias audiovizive të ofruar nga një ofrues i shërbimit të medias për të parë programet në momentin e zgjedhur nga vetë përdoruesi dhe me kërkesën e tij individuale, mbi bazën e një katalogu programesh të përzgjedhura nga ofruesi i shërbimit të medias;
  - h) “Komunikim audioviziv tregtar” do të thotë imazhet e shoqëruar me ose pa zë, të cilat janë projektuar për të promovuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mallrat, shërbimet ose imazhin e një personi fizik ose juridik që ushtron veprimtari ekonomike.

Këto imazhe shoqërojnë ose janë të përfshira në një program ose video të krijuar nga publiku, kundrejt pagesës ose një shpërblimi të ngjashëm, ose për qëllime vetëpromovuese. Ndër format e komunikimit audioviziv tregtar janë reklamata televizive, sponsorizimi, teleshitjet dhe vendosja e produktit;

- i) “Reklamë televizive” do të thotë çdo formë mesazhi të transmetuar, qoftë kundrejt pagesës apo një shpërblimi të ngjashëm, ose transmetimi për qëllime vetëpromovuese, nga një shoqëri publike ose privat ose person fizik në kuadër të një aktiviteti tregtar, industrial, artizanal ose një profesioni, për të promovuar furnizimin e mallrave ose shërbimeve, përfshirë pasuri të paluajtshme, të drejta dhe detyrime, kundrejt pagesës;
- j) “Komunikim audioviziv tregtar i fshehtë” do të thotë prezantimin verbal ose shfaqjen e fotografisë së mallrave, shërbimeve, emrit, markës tregtare ose veprimtarisë së një

prodhuesi mallrash apo të një ofruesi shërbimesh në programe, kur një prezantim i tillë bëhet qëllimisht nga ofruesi i shërbimit të medias për të shërbyer si reklamë dhe mund të mashtrojë publikun për natyrën e tij. Ky prezantim do të konsiderohet si i qëllimshëm veçanërisht nëse bëhet kundrejt pagesës ose të një shpërblimi të ngjashëm;

- k) “Sponsorizim” do të thotë çdo kontribut i dhënë nga shoqëritë publike ose private, apo persona fizikë, që nuk janë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve të medias audiovizive ose shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove, ose në prodhimin e veprave audiovizive, për financimin e shërbimeve të medias audiovizive, shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove, ose videove të krijuara nga publiku apo programeve, me qëllim promovimin e emrit, markës tregtare, imazhit, aktiviteteve apo produkteve;
  - l) “Teleshitje” do të thotë transmetimi i ofertave të drejtpërdrejta për publikun me qëllim furnizimin e mallrave ose shërbimeve, përfshirë pasuri të paluajtshme, të drejta dhe detyrime, kundrejt pagesës;
  - m) “Vendosje e produktit” do të thotë çdo formë të komunikimit audioviziv tregtar ku përfshihet ose referohet një produkt, një shërbim ose marka tregtare e tyre në mënyrë të tillë që shfaqet në një program ose një video të krijuar nga publiku, kundrejt pagesës ose një shpërblimi të ngjashëm;
  - n) “Vepra evropiane” do të thotë:
    - (i) veprat me origjinë nga shtetet anëtare;
    - (ii) veprat me origjinë nga një shtet i tretë evropian palë në Konventën Evropiane për Televizionin Ndërkufitar të Këshillit të Evropës dhe që përmbush kërkesat e pikës 3;
    - (iii) veprat e bashkëprodhuara në kuadër të marrëveshjeve të lidhura për sektorin audioviziv mes Bashkimit dhe vendeve të treta dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në secilën prej këtyre marrëveshjeve.
2. Dispozitat e shkronjës (n) (ii) dhe (iii) të pikës 1 do të zbatohet me kusht që veprat me origjinë nga shtetet anëtare të mos i nënshtrohet masave diskriminuese në vendin e tretë të interesuar.
3. Veprat e referuara në shkronjën (n)(i) dhe (ii) të pikës 1 janë vepra të realizuara kryesisht me kontributin e autorëve dhe punëtorëve rezidentë të një ose më shumë shteteve të referuara në këto dispozita, me kusht që ato të jenë në përputhje me një nga tri kushtet e mëposhtme:
- (i) të jenë realizuar nga një ose më shumë prodhues të themeluar në një ose më shumë nga këto shtete;
  - (ii) prodhimi i këtyre veprave është mbikëqyrur dhe kontrolluar në mënyrë efektive nga një ose më shumë prodhues të themeluar në një ose më shumë nga këto shtete;
  - (iii) kontributi i bashkëprodhuesve të këtyre shteteve përbën shumicën e kostos totale të bashkëprodhimit, dhe bashkëprodhimi nuk kontrollohet nga një ose më shumë prodhues të themeluar jashtë atyre shteteve.

4. Veprat që nuk janë vepra evropiane sipas kuptimit të shkronjës (n) të pikës 1, por që janë prodhuar në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe të bashkëprodhimit të lidhura mes shteteve anëtare dhe vendeve të treta, do të konsiderohen si vepra evropiane vetëm nëse bashkëprodhuesit e Bashkimit të kenë kontribuar në shumicën e kostos totale të prodhimit dhe që prodhimi të mos jetë i kontrolluar nga një ose më shumë prodhues të themeluar jashtë territorit të shteteve anëtare.

## KAPITULLI II

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR SHËRBIMET E MEDIAS AUDIOVISIVE

#### *Neni 2*

1. Çdo shtet anëtar do të marrë masa të sigurojë që të gjitha shërbimet e medias audiovizive të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve të medias, nën juridiksionin e tij, të respektojnë rregullat e rendit juridik të zbatueshme për shërbimet e medias audiovizive të synuara për publikun në atë shtet anëtar.
2. Për qëllime të kësaj Direktive, ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e një shteti anëtar janë:
  - a) ofruesit e themeluar në atë shtet anëtar në përputhje me pikën 3;
  - b) ofruesit për të cilët zbatohet pika 4.
3. Për qëllime të kësaj Direktive, një ofrues i shërbimit të medias do të konsiderohet se është themeluar në një shtet anëtar në rastet e mëposhtme:
  - (a) selia qendrore e ofruesit të shërbimit të media ndodhet në atë shtet anëtar dhe vendimet editoriale rreth shërbimit të medias audiovizive merren në atë shtet anëtar;
  - (b) nëse selia qendrore e një ofruesi të shërbimit të medias ndodhet në një shtet anëtar, por vendimet editoriale për shërbimin e medias audiovizive merren në një shtet tjetër anëtar, ofruesi i shërbimit të medias do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar ku operon një pjesë e konsiderueshme e punëmarrësve të pajtuar për realizimin e veprimtarisë së shërbimit të medias audiovizive.

Nëse një pjesë e rëndësishme e punëmarrësve të pajtuar për realizimin e veprimtarisë së shërbimit të medias audiovizive operon në secilin nga këto shtete anëtare, ofruesi i shërbimit të medias do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar ku ka selinë qendrore.

Nëse një pjesë e rëndësishme e punëmarrësve të pajtuar për realizimin e veprimtarisë së shërbimit të medias audiovizive nuk operon në asnjë nga këto shtete anëtare, ofruesi i shërbimit të medias do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar ku ka nisur fillimisht veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin e atij shteti anëtar, me kusht që të mbajë një lidhje të qëndrueshme dhe efektive me ekonominë e atij shteti anëtar;
  - (c) nëse selia qendrore e një ofruesi të shërbimit të media ndodhet në atë shtet anëtar, por vendimet për shërbimin e medias audiovizive merren në një shtet të tretë, ose anasjelltas, ai do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar në fjalë, me kusht që një pjesë e rëndësishme e punëmarrësve të pajtuar për realizimin e veprimtarisë së shërbimit të medias audiovizive operon në atë shtet anëtar.

4. Ofruesit e shërbimeve të medias ndaj të cilëve nuk zbatohen dispozitat e pikës 3 do të konsiderohen se janë subjekte nën juridiksionin e një shteti anëtar në rastet e mëposhtme:
  - (a) nëse përdorin një lidhje satelitore (up-link) të montuar në atë shtet anëtar;
  - (b) nëse, pavarësisht se nuk përdorin një lidhje satelitore (up-link) të montuar në atë shtet anëtar, ata përdorin fuqinë satelitore të atij shteti anëtar.
5. Nëse nuk është e mundur të përcaktohet se cili shtet anëtar ka juridiksionin, sipas pikave 3 dhe 4, shteti anëtar kompetent është ai ku ofruesi i shërbimit të medias është themeluar sipas kuptimit të neneve 49 deri 55 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

5a. shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të medias informojnë autoritetet ose organet kompetente rregullatore kombëtare për çdo ndryshim që mund të ndikojë në përcaktimin e juridiksionit sipas pikave 2, 3 dhe 4.

5b. shtetet anëtare do të krijojnë dhe mbajnë një listë të përditësuar të ofruesve të shërbimeve të medias, nën juridiksionin e tyre, dhe do të përcaktojnë se mbi cilat prej kriterëve të pikave 2 deri 5 bazohet juridiksioni i tyre. Këtë listë, shtetet anëtare ia bëjnë me dije Komisionit, përfshirë çdo përditësim të saj.

Komisioni do të sigurojë që këto lista të vihen në dispozicion në një bazë të dhënash të centralizuar. Në rast mospërputhje mes listave, Komisioni do të kontaktojë shtetet anëtare përkatëse për të gjetur një zgjidhje. Komisioni siguron që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të kenë qasje në këtë bazë të dhënash. Komisioni do të vendosë informacionin e bazës së të dhënave në dispozicion të publikut.

5c. Nëse, në zbatim të nenit 3 ose 4, shtetet anëtare të interesuara nuk bien dakord se cili shtet anëtar ka juridiksion, çështja do t'i dërgohet menjëherë Komisionit. Komisioni mund t'i kërkojë Grupit Evropian të Rregullatorëve të Shërbimeve të Medias Audiovizive (GERSHAV) të japë mendim për këtë çështje, në përputhje me shkronjën (d) të nenit 30b (3). GERSHAV-i jep mendim brenda 15 ditë pune nga marrja e kërkesës së Komisionit. Komisioni do të informojë rregullisht Komitetin e Kontaktit të themeluar sipas nenit 29 .

Kur Komisioni miraton një vendim sipas nenit 3 (2) ose 3 (3), ose nenit 4 (5), ai do të vendosë gjithashtu se cili shtet anëtar ka juridiksion.

6. Kjo Direktivë nuk zbatohet për shërbimet e mediave audiovizive të synuara ekskluzivisht për vendet e treta dhe të cilat nuk merren në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga publiku i një ose më shumë shteteve anëtare me anë të aparaturave standarde të konsumatorit.

### *Neni 3*

1. Shtetet anëtare sigurojnë lirinë e marrjes dhe nuk kufizojnë, në territorin e tyre, ritransmetimin e shërbimeve të mediave audiovizive nga shtetet e tjera anëtare për arsye që lidhen me sektorë të koordinuar nga kjo Direktivë.
2. Një shtet anëtar mund të përjashtojë përkohësisht zbatimin e pikës 1 të këtij neni nëse një shërbim i medias audiovizive i ofruar nga një ofrues i shërbimit të medias nën juridiksionin e një Shteti tjetër Anëtar shkel haptazi, në mënyrë të rëndë dhe serioze nenin

6(1)(a) ose nenin 6a(1) ose cenon apo përbën një rrezik të rëndë e serioz ndaj shëndetit publik.

Përfshirja e referuar në nënparagrafin e parë më sipër, i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

- (a) gjatë 12 muajve të fundit, ofruesi i shërbimit të medias, në të paktën dy raste të mëparshme, ka kryer një ose më shumë nga sjelljet e përshkruara në nënparagrafin e parë;
- (b) shteti anëtar në fjalë ka njoftuar me shkrim ofruesin e shërbimit të medias, shtetin anëtar që ka juridiksionin mbi atë ofrues dhe Komisionin mbi shkeljet e pretenduara dhe për masat proporcionale që synon të ndër marrë në rast se një nga këto shkelje ndodh përsëri;
- (c) shteti anëtar në fjalë ka respektuar të drejtën e ofruesit të shërbimit të medias për tu mbrojtur dhe, në veçanti, i ka dhënë këtij ofruesi mundësinë të shprehë mendimet e tij mbi shkeljet e pretenduara; dhe
- (d) konsultimet me shtetin anëtar që ka juridiksionin mbi ofruesin e shërbimit të medias dhe Komisionin nuk kanë sjellë një zgjidhje miqësore brenda një muaji nga data që komisioni ka marrë njoftimin e referuar në shkronjën (b).

Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit për masat e marra nga shteti anëtar në fjalë dhe pasi t'i ketë kërkuar GERSHAV-it mendimin e tij në përputhje me shkronjën (d) të nenit 30b(3), Komisioni vendosë nëse këto masa janë në përputhje me të drejtën e Bashkimit. Komisioni do të informojë rregullisht Komitetin e Kontaktit. Kur Komisioni vendos që këto masa janë të papajtueshme me të drejtën e Bashkimit, i kërkon shtetit anëtar në fjalë që të pushojë urgjentisht këto masa.

3. Një shtet anëtar mund të përjashtojë përkohësisht zbatimin e pikës 1 të këtij neni nëse një shërbim i medias audiovizive i ofruar nga një ofrues i shërbimit të medias nën juridiksionin e një shteti tjetër anëtar shkel haptazi, në mënyrë të rëndë e serioze shkronjën (b) të nenit 6(1) ose cenon apo përbën një rrezik të rëndë e serioz ndaj sigurisë publike, përfshirë sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare.

Përfshirja e referuar në nënparagrafin e parë më sipër, i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

- (a) gjatë 12 muajve të fundit, sjellja e përmendur në nënparagrafin e parë ka ndodhur të paktën një herë më parë;

dhe

- (b) Shteti anëtar në fjalë ka njoftuar me shkrim ofruesin e shërbimit të medias, shtetin anëtar që ka juridiksionin mbi atë ofrues dhe Komisionin mbi shkeljet e pretenduara dhe masat proporcionale që synon të ndër marrë nëse ndonjë kjo shkelje ndodh përsëri.

Shteti anëtar në fjalë ka respektuar të drejtën e ofruesit të shërbimit të medias për tu mbrojtur dhe, në veçanti, i ka dhënë këtij ofruesi mundësinë të shprehë mendimet e tij mbi shkeljet e pretenduara.

Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit për masat e marra nga shteti anëtar në fjalë dhe pasi t'i ketë kërkuar GERSHAV-it mendimin e tij në përputhje me shkronjën (d) të nenit 30b(3), Komisioni vendosë nëse këto masa janë në përputhje me të drejtën e Bashkimit. Komisioni do të informojë rregullisht Komitetin e Kontaktit. Kur Komisioni vendos që këto masa janë të papajtueshme me të drejtën e Bashkimit, i kërkon shtetit anëtar në fjalë që të pushojë urgjentisht këto masa.

4. Pikat 2 dhe 3 nuk do të cenojnë zbatimin e cilësdo procedure, mjeti juridik apo sanksioni kundër këtyre shkeljeve në shtetin anëtar që ka juridiksion mbi ofruesin në fjalë të shërbimit të medias.
5. Në raste urgjente, shtetet anëtare mund të përjashtojnë, jo më vonë se një muaj pas shkeljes së pretenduar, nga zbatimi kushtet e parashtruara në shkronjat (a) dhe (b) të pikës 3. Në këtë rast, masat e marra i njoftohen, sa më shpejt që të jetë e mundur, Komisionit dhe shtetit anëtar nën juridiksionin e të cilit është ofruesi i shërbimit të medias, duke përcaktuar edhe shkaqet që shteti anëtar i konsideron si çështje urgjente. Komisioni do të verifikojë, brenda një kohe sa më shpejt që të jetë e mundur, pajtueshmërinë e masave të njoftuara me ligjin e Bashkimit. Kur Komisioni arrin në konkluzionin se këto masa janë të papajtueshme me të drejtën e Bashkimit, i kërkon shtetit anëtar në fjalë që të pushojë urgjentisht këto masa.
6. Nëse Komisionit i mungon informacioni i nevojshëm për të marrë një vendim në pajtim me pikën 2 ose 3, brenda një muaji nga marrja e njoftimit, i kërkon shtetit anëtar të gjitha informacionet e nevojshme për të marrë këtë vendim. Afati brenda të cilit Komisioni merr vendimin do të pezullohet derisa shteti anëtar në fjalë të ketë dhënë informacione e nevojshëm. Në çdo rast, pezullimi i afatit nuk do të zgjasë më shumë se një muaj.
7. Shtetet anëtare dhe Komisioni shkëmbejnë rregullisht përvojat dhe praktikat më të mira në lidhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen, në kuadër të Komitetit të Kontaktit dhe GERSHAV-it.

#### *Neni 4*

1. Shtetet anëtare ruajnë të drejtën t'ju kërkojnë ofruesve të shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre që të respektojnë rregulla më të hollësishme ose më ashpra në fushat e koordinuara nga kjo Direktivë, me kusht që këto rregulla të jenë në përputhje me të drejtën e Bashkimit.
2. Kur një shtet anëtar:
  - (a) ka ushtruar të drejtën e tij sipas pikës 1 për të miratuar rregulla më të hollësishme ose më të ashpra me interes të përgjithshëm publik; dhe
  - (b) vlerëson se një ofrues i shërbimit të medias nën juridiksionin e një shteti tjetër anëtar ofron një shërbim të medias audiovizive, i cili tërësisht ose kryesisht i drejtohet territorit të tij,mund t'i kërkojë shtetit anëtar që ka juridiksion të trajtojë çdo problem të identifikuar në lidhje me këtë pikë. Të dyja shtetet anëtare do të bashkëpunojnë me besnikëri dhe shpejtësi me qëllim arritjen e një zgjidhje që është e kënaqshme për të dyja palët.

Me marrjen e një kërkesë të arsyetuar sipas nënparagrafit të parë, shteti anëtar që ka juridiksion do t'i kërkojë ofruesit të shërbimit të medias që të respektojë rregullat e interesit të përgjithshëm publik në fjalë. Shteti anëtar që ka juridiksionin do të informojë rregullisht shtetin anëtar kërkuar në lidhje me hapat e ndërmarrë për të trajtuar problemet e identifikuar. Në rast se nuk gjendet një zgjidhje, shteti anëtar që ka juridiksionin do të informojë shtetin anëtar kërkuar dhe Komisionin, brenda dy muajve nga marrja e kërkesës, për rezultatet e arritura dhe do të shpjegojë shkaqet pse nuk ka mundur të gjejë një zgjidhje.

Secili shtet anëtar mund të ftojë Komitetin e Kontaktit për të shqyrtuar çështjen në çdo kohë.

3. Shteti anëtar në fjalë mund të marrë masat e duhura kundër ofruesit të shërbimeve të medias në fjalë, kurdoherë që:

(a) vlerëson se rezultatet e arritura përmes zbatimit të pikës 2 nuk janë të kënaqshme; dhe

(b) ka paraqitur prova që tregojnë se ofruesi i shërbimit të medias në fjalë është themeluar në një shtet anëtar tjetër që ka juridiksion, për t'iu shmangur rregullave më të ashpra, në fushat e koordinuara nga kjo Direktivë, të cilat do të ishin të zbatueshme për të nëse do të ishte themeluar në shtetin anëtar në fjalë. Këto prova arrijnë të konstatojnë me siguri e në mënyrë të arsyeshme këtë shmangie, pa qenë e nevojshme të provohet qëllimi i ofruesit të shërbimit të medias për t'iu shmangur këtyre rregullave më të ashpra.

Këto masa duhet të jenë objektivist të nevojshme, të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese dhe në përpjesëtim të drejtë me objektivat që ato synojnë të arrijnë.

4. Një shtet anëtar mund të marrë masa sipas pikës 3 vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

(a) të ketë njoftuar Komisionin dhe shtetin anëtar, ku ofruesi i shërbimit të medias është themeluar, për qëllimin e tij për të ndërmarrë këto masa, duke paraqitur në mënyrë të arsyetuar shkaqet ku bazohet vlerësimi i tij;

(b) të ketë respektuar të drejtën e ofruesit të shërbimeve të medias në fjalë për tu mbrojtur dhe, veçanërisht, t'i ketë dhënë ofruesit të shërbimit të medias mundësinë për të shprehur mendimet e tij mbi shmangien e pretenduar dhe masat që ky shtet anëtar njoftues synon të ndërmarrë; dhe

(c) pasi t'i ketë kërkuar GERSHAV-it mendimin e tij në përputhje me shkronjën (d) të nenit 30b(3), Komisioni ka vendosur se masat janë në përputhje me të drejtën e Bashkimit, e në veçanti që vlerësimet e bëra nga shteti anëtar që do të ndërmarrë masat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni janë të mbështetura siç duhet. Komisioni do të informojë rregullisht Komitetin e Kontaktit.

5. Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit të parashikuar në shkronjën (a) të pikës 4, Komisioni do të vendosë nëse këto masa janë në pajtim me të drejtën e Bashkimit. Kur Komisioni vendos që këto masa janë të papajtueshme me të drejtën e Bashkimit, i kërkon



shtetit anëtar në fjalë që të mos ndërmarrë masat e synuara. Nëse Komisionit i mungon informacioni i nevojshëm për të marrë një vendim në pajtim me nënparagrafin e parë, brenda një muaji nga marrja e njoftimit, i kërkon shtetit anëtar të gjitha informacionet e nevojshme për të marrë këtë vendim. Afati brenda të cilit Komisioni merr vendimin do të pezullohet derisa shteti anëtar në fjalë të ketë dhënë informacion e nevojshëm. Në çdo rast, pezullimi i afatit nuk do të zgjasë më shumë se një muaj.

6. Shtetet anëtare do të sigurojnë, me anë të mjeteve të përshtatshme, brenda kuadrit të së drejtës së tyre kombëtare, që ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre të respektojnë realisht këtë Direktivë.

7. Direktiva 2000/31/KE do të zbatohet, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Direktivë. Në rast konflikti ndërmjet Direktivës 2000/31/KE dhe kësaj Direktive, do të mbizotërojë kjo Direktivë, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Direktivë.

#### *Neni 4a*

1. Shtetet anëtare do të inkurajojnë përdorimin e rregulloreve të përbashkëta dhe do të nxisin vetë-rregullimin përmes kodeve të sjelljes, të miratuara në nivel kombëtar, në fushat e koordinuara nga kjo Direktivë, deri në masën e lejuar nga rendet e tyre juridike. Këto kodet duhet:
  - (a) të jenë të konceptuar në mënyrë që të pranohen gjerësisht nga palët e interesit në shtetet anëtare;
  - (b) të përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë objektivat e tyre;
  - (c) të parashikojnë një monitorim dhe vlerësim të rregullt, transparent e të pavarur të arritjes së objektivave të synuara; si dhe
  - (d) të sigurojnë një zbatim efektiv, përfshirë sanksione të efektshme dhe proporcionale.
2. Shtetet anëtare dhe Komisioni mund të nxisin vetë-rregullimin me anë të kodeve të sjelljes të Bashkimit të hartuara nga ofruesit e shërbimeve të medias, ofruesit e shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove ose organizatat që i përfaqësojnë, në bashkëpunim, nëse është e nevojshme, me sektorë të tjerë si industria, tregtia, shoqatat dhe organizatat profesionale dhe të konsumatorëve. Këto kode duhet të jenë konceptuar në mënyrë që të pranohen gjerësisht nga palët e interesit në nivel Bashkimi dhe të jenë në përputhje me shkronjat (b) deri (d) të pikës 1. Kodet e sjelljes së Bashkimit nuk do të cenojnë kodet kombëtare të sjelljes.

Në bashkëpunim me shtetet anëtare, Komisioni do të lehtësojë hartimin e kodeve të sjelljes të Bashkimit, nëse do të jetë e nevojshme, në përputhje me parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Palët nënshkruese të kodeve të sjelljes të Bashkimit do t'i dorëzojnë Komisionit projektkodet, së bashku me ndryshimet e tyre. Komisioni do të konsultohet me Komitetin e Kontaktit për këto projektkode ose ndryshimet e tyre.

Komisioni do të vendosë në dispozicion të publikut kodet e sjelljes të Bashkimit dhe mund t'u japë atyre publicitetin e përshtatshëm.

3. Shtetet anëtare ruajnë të drejtën t'ju kërkojnë ofruesve të shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre që të të respektojnë rregulla më të hollësishme ose më ashpra në përputhje me këtë Direktivë dhe të drejtën e Bashkimit Evropian, qoftë edhe në ato raste kur autoritetet ose organizmat e tyre kombëtare rregullatore e të pavarura konstatojnë se një kod sjellje ose pjesë të tij kanë dëshmuar se nuk janë mjaftueshëm të efektshëm. Shtetet anëtare i raportojnë menjëherë këto rregulla Komisionit.

### KAPITULLI III

## DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR SHËRBIMET E MEDIAS AUDIOVISIVE

#### *Neni 5*

1. Çdo shtet anëtar do të sigurojë që një ofrues i shërbimeve të medias, nën juridiksionin e tij, t'iu ofrojë marrësve të shërbimeve qasje në mënyrë të thjeshtë, të drejtpërdrejtë e të përhershme në të paktën informacionin e mëposhtëm:
  - (a) emrin e tij;
  - (b) adresën ku është themeluar;
  - (c) hollësi të tjera, përfshirë adresën e tij të postës elektronike ose faqen e internetit, që mundësojnë të kontaktohet shpejt e në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive;
  - (d) Shtetin anëtar që ka juridiksionin mbi të dhe autoritetet ose organet rregullatore ose organet mbikëqyrëse kompetente.
2. Shtetet anëtare mund të miratojnë masa ligjore, të cilat parashikojnë se, përveç informacionit të shënuar në pikën 1, ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre duhet të bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të ortakërisë, përfshirë edhe pronarët konkret. Këto masa duhet të respektojnë të drejtat themelore, si e drejta për jetë private dhe familjare e pronarëve konkret. Këto masa duhet të jenë të nevojshme dhe proporcionale dhe do të synojnë të arrijnë një objektiv me interes të përgjithshëm.

#### *Neni 6*

1. Pa cenuar detyrimin e shteteve anëtare për të respektuar dhe mbrojtur dinjitetin e njeriut, shtetet anëtare do të sigurojnë, me anë të mjeteve të përshtatshme, që shërbimet e medias audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre:
  - (a) nuk përmbajnë nxitje për dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtar të një grupi mbi bazën e një prej arsyeve të dhëna në nenin 21 të Kartës;
  - (b) nuk provokojnë publikun për kryer vepra terroriste, siç përcaktohet në nenin 5 të Direktivës (BE) 2017/541.
2. Masat e marra për qëllime të këtij neni duhet të jenë të nevojshme dhe proporcionale dhe të respektojnë të drejtat dhe parimet e përcaktuara në Kartë.

#### *Neni 6a*

1. Shtetet anëtare do të marrin masa të duhura për të siguruar që shërbimet e medias audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve do të vihen në dispozicion vetëm në atë mënyrë që siguron se të miturit normalisht nuk do t'i dëgjojnë ose shohin ato. Këto masa mund të përfshijnë përzgjedhjen e kohës së transmetimit,

mjetet e verifikimit të moshës ose masa të tjera teknike. Ato duhet të jenë në proporcion të drejtë me dëmin e mundshëm të programit.

Përmbajtjet më të dëmshme, siç është dhuna dhe pornografia e ofruar falas, do t'i nënshtrohen masave më të rrepta.

2. Të dhënat personale të të miturve të mbledhura apo ndryshe të nxjerra nga ofruesit e shërbimeve të medias, sipas pikës 1, nuk do të përpunohen për qëllime tregtare, të tilla si marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe reklamimi mbi bazë sjellje.
3. Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të medias t'iu ofrojnë shikuesve informacion të mjaftueshëm mbi përmbajtjen që mund të dëmtojë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të medias duhet të përdorin një sistem që përshkruan natyrën potencialisht të dëmshme të përmbajtjes së një shërbimi të medias audiovizive.  
Për zbatimin e kësaj pike, shtetet anëtare do të inkurajojnë përdorimin e rregulloreve të përbashkëta, siç parashikohet në nenin 4a (1).
4. Komisioni do të inkurajojë ofruesit e shërbimeve të medias të shkëmbejnë praktikat më të mira në lidhje me kodet e sjelljes. Për qëllime të këtij neni, shtetet anëtare dhe Komisioni mund të nxisin vetë-rregullimin me anë të kodeve të sjelljes të Bashkimit, sipas nenit 4a (2).

#### *Neni 7*

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë, pa vonesa të panevojshme, që shërbimet e ofruara nga ofruesit e medias nën juridiksionin e tyre të bëhen vazhdimisht dhe në mënyrë progresive më të arritshme për personat me aftësi të kufizuara, përmes masave proporcionale.
2. Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të medias të raportojnë rregullisht tek autoritetet ose organet kombëtare rregullatore mbi zbatimin e masave të përmendura në pikën 1. Brenda datës 19 dhjetor 2022 dhe, më pas, çdo tre vjet, shtetet anëtare do t'i raportojnë Komisionit mbi zbatimin e pikës 1.
3. Shtetet Anëtare do të inkurajojnë ofruesit e shërbimeve të medias të hartojnë plane veprimi për qasjen në shërbime në mënyrë të vazhdueshme e progresive duke i bërë shërbimet e tyre më të arritshme nga personat me aftësi të kufizuara. Çdo plan i tillë veprimi do t'i komunikohet autoriteteve ose organeve kombëtare rregullatore.
4. Çdo shtet anëtar emëron një pikë kontakti të vetme, në linjë, lehtësisht të arritshme, edhe për personat me aftësi të kufizuara, dhe në dispozicion të publikut për të ofruar informacion dhe marrjen e ankesave në lidhje me çështjet e qasjes të përmendura në këtë nen.
5. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që informacioni i urgjencës, përfshirë komunikimet publike dhe njoftimet në rast fatkeqësish natyrore, i vënë në dispozicion të publikut përmes shërbimeve të medias audiovizive, të ofrohet në mënyrë që të jetë i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara.

#### *Neni 7a*

Shtetet anëtare mund të marrin masa për të siguruar dukshmërinë e duhur të shërbimeve të medias audiovizive me interes të përgjithshëm.

#### *Neni 7b*

Shtetet anëtare do të marrin masat e përshtatshme dhe proporcionale për të siguruar që shërbimet e medias audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të medias të mos fshehin qëllime tregtare apo të modifikohen, pa pëlqimin e shprehur të këtyre ofruesve.

Për qëllime të këtij neni, shtetet anëtare do të përcaktojnë rregulla të hollësishme, përfshirë përjashtime, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e interesave legjitime të përdoruesve, duke marrë parasysh interesat legjitime të ofruesve të shërbimeve të medias që ka ofruar fillimisht shërbimet e medias audiovizive.

#### *Neni 8*

Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre të mos transmetojnë vepra kinematografike jashtë periudhave të miratuara me titullarët e të drejtave.

#### *Neni 9*

1. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që komunikimet audiovizive tregtare të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre, të respektojnë kërkesat e mëposhtme:
  - (a) komunikimet audiovizive tregtare do të jenë lehtësisht të dallueshëm si të tilla; komunikimet audiovizive tregtare të fshehta janë të ndaluara;
  - (b) komunikimet audiovizive tregtare nuk do të përdorin teknika të joshjes subkoshiente;
  - (c) komunikimet audiovizive tregtare:
    - (i) nuk do të shkelin respektin për dinjitetin njerëzor;
    - (ii) nuk do të përfshijnë ose promovojnë cilindo diskriminim mbi bazë gjinore, race ose etnie, kombësie, feje apo besimi, paaftësie, moshe apo orientimi seksual;
    - (iii) nuk do të inkurajojnë sjellje që janë të dëmshme për shëndetin ose sigurinë;
    - (iv) nuk do të inkurajojnë sjellje që shkaktojnë dëme të rënda ndaj mbrojtjes së mjedisit;
  - (d) çfarëdolloj forme e komunikimeve audiovizive tregtare për cigaren dhe produkte të tjera të duhanit, qoftë edhe për cigaret elektronike dhe mbajtësit e lëngjeve me rimbushje, është e ndaluara;
  - (e) komunikimet audiovizive tregtare për pijet alkoolike nuk do t'iu drejtohen veçanërisht të miturve, si dhe nuk do të nxisin konsumin e tepruar të këtyre pijeve;
  - (f) komunikimet audiovizive tregtare për produktet mjekësore dhe trajtime mjekësore që jepen vetëm me recetë në shtetin anëtar që ka juridiksion mbi ofruesin e shërbimit të medias, janë të ndaluara;
  - (g) komunikimet audiovizive tregtare nuk do të shkaktojnë dëmtime fizike, mendore ose morale tek të miturit. Prandaj, nuk do të nxisin të miturit në mënyrë të drejtpërdrejtë

që të blejnë ose të marrin një produkt ose shërbim duke shfrytëzuar mungesën e tyre të përvojës ose faktin që ata besojnë lehtë, dhe as nuk do t'i inkurajojnë ata drejtpërdrejt të bindin prindërit ose të tjerë që të blejnë mallrat ose shërbimet e reklamuar, dhe as nuk do të shfrytëzojnë besimin e veçantë që të miturit kanë tek prindërit, mësuesit apo persona të tjerë, apo të shfaqin pa arsye të mitur në situata të rrezikshme.

2. Komunikimet audiovizive tregtare për pijet alkoolike në shërbimet e medias audiovizive me kërkesë, me përjashtim të sponsorizimit dhe vendosjes së produktit, duhet të respektojnë kriteret e përcaktuara në nenin 22.
3. Shtetet anëtare do të inkurajojnë përdorimin e rregulloreve të përbashkëta dhe do të nxisin vetë-rregullimin përmes kodeve të sjelljes, siç parashikohet në nenin 4a (1), në lidhje me komunikimet audiovizive tregtare të papërshtatshme për pijet alkoolike. Këto kode synojnë të zvogëlojnë në mënyrë të efektshme ekspozimin e të miturve ndaj komunikimeve audiovizive tregtare për pijet alkoolike.
4. Shtetet anëtare do të inkurajojnë përdorimin e rregulloreve të përbashkëta dhe do të nxisin vetë-rregullimin përmes kodeve të sjelljes, siç parashikohet në nenin 4a (1) në lidhje me komunikimet audiovizive tregtare të papërshtatshme, që shoqërojnë ose janë të përfshira në programet e fëmijëve, për ushqime dhe pije që përmbajnë lëndë ushqyese dhe substanca me ndikim ushqyës ose fiziologjik, veçanërisht yndyra, acide trans-yndyrore, kripë ose natrium dhe sheqerna, marrja me tepri e të cilave nuk rekomandohet në dietën e përgjithshme.

Këto kode synojnë të zvogëlojnë në mënyrë të efektshme ekspozimin e fëmijëve ndaj komunikimeve audiovizive tregtare për këto ushqime dhe pije. Ato synojnë të sigurojnë që komunikime tilla audiovizive tregtare të mos të theksojnë cilësinë pozitive të aspekteve ushqyese të këtyre ushqimeve dhe pijeve.

5. Për qëllime të këtij neni, shtetet anëtare dhe Komisioni mund të nxisin vetë-rregullimin me anë të kodeve të sjelljes të Bashkimit, sipas nenit 4a (2).

#### *Neni 10*

1. Shërbimet e medias audiovizive ose programet e sponsorizuara duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - (a) përmbajtja e tyre dhe, në rastin e transmetimeve televizive, orari i tyre, në asnjë rast nuk do të ndryshohet në mënyrë të atillë që komprometon përgjegjësinë dhe pavarësinë editoriale të ofruesit të shërbimit të medias;
  - (b) nuk do të nxisin drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht duke bërë referenca të posaçme promovionale për ato mallra ose shërbime;
  - (c) telespektatorët do të informohen qartazi për ekzistencën e një marrëveshje sponsorizimi. Programet e sponsorizuara duhet të identifikohen qartazi si të tilla me emrin, logon dhe/ose çdo simbol tjetër të sponsorit, të tilla si një referencë për

produktin ose shërbimin e tij ose një shenjë dalluese të tij në mënyrë të përshtatshme për programet, në fillim, gjatë dhe/ose në fund të programeve.

2. Shërbimet ose programet e medias audiovizive nuk do të sponsorizohen nga shoqëri, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi ose shitja e cigareve dhe produkteve të tjera të duhanit, si dhe e cigareve elektronike dhe e mbajtësve të lëngjeve me rimbushje.
3. Sponsorizimi i shërbimeve apo programeve të medias audiovizive nga shoqëri, veprimtaria e të cilave përfshin prodhimin ose shitjen e produkteve mjekësore dhe trajtime mjekësore, mund të promovojë emrin ose imazhin e shoqërisë, por nuk do të promovojë produkte mjekësore ose trajtime mjekësore specifike që jepen vetëm me recetë, në shtetit anëtar nën juridiksionin e të cilit është ofruesi i shërbimit të medias.
4. Programet e lajmeve dhe çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen. Shtetet anëtare mund të ndalojnë sponsorizimin e programeve për fëmijë. Shtetet anëtare mund të zgjedhin të ndalojnë shfaqjen e logos së një sponsori gjatë programeve për fëmijë, dokumentarëve dhe programeve fetare.

#### *Neni 11*

1. Ky nen do të zbatohet vetëm për programet e prodhuara pas datës 19 dhjetor 2009.
2. Vendosja e produkteve do të lejohet në të gjitha shërbimet e medias audiovizive, me përjashtim të programeve të lajmeve dhe çështjeve aktuale, programeve për çështjet e konsumatorit, programeve fetare dhe programeve për fëmijë.
3. Programet që përmbajnë shfaqjen e një produkti duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - (a) përmbajtja dhe organizimi i tyre sipas një orari, në rastin e transmetimeve televizive, ose sipas një katalogu, në rastin e shërbimeve të medias audiovizive me kërkesë, në asnjë rast nuk do të ndryshohen në mënyrë të atillë që komprometon përgjegjësinë dhe pavarësinë editoriale të ofruesit të shërbimit të medias;
  - (b) nuk do të nxisin drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht duke bërë referenca të posaçme promovionale për ato mallra ose shërbime;
  - (c) nuk do t'i japin rëndësi të panevojshme produktit në fjalë;
  - (d) telespektatorët do të informohen qartazi për ekzistencën e vendosjes së produktit me anë të një identifikimi të përshtatshëm në fillim dhe në fund të programit, si dhe kur një program rifillon pas një pushimi reklame, në mënyrë që të shmanget çdo konfuzion nga ana e telespektatorëve.

Shtetet anëtare mund të heqin dorë nga zbatimi i kërkesave të shkronjës (d), me përjashtim të programeve të prodhuara ose të porositura nga një ofrues i shërbimit të medias ose nga një shoqëri e lidhur me të.

4. Për çdo rast, programet nuk duhet të përmbajnë vendosje të produkteve të mëposhtme:
  - (a) cigaret dhe produkte të tjera të duhanit, si dhe cigaret elektronike dhe mbajtësit e lëngjeve me rimbushje, ose vendosje të produkteve të shoqërive, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi ose shitja e këtyre produkteve;
  - (b) produktet mjekësore dhe trajtimet mjekësore që jepen vetëm me receta në shtetin anëtar që ka juridiksion mbi ofruesin e shërbimit të medias.

## KAPITULLI IV

### *Neni 13*

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të medias me kërkesë nën juridiksionin e tyre, të garantojnë që në katalogët e tyre të kenë paktën 30% të tregut të veprave evropiane dhe që ato të jenë të dukshme.
2. Në rast se shtetet anëtare kërkojnë që ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre të kontribuojnë financiarisht në prodhimin e veprave evropiane, përfshirë investimet e drejtpërdrejta në përmbajtje dhe kontribut në fondet kombëtare, mund të kërkojnë gjithashtu që edhe ofruesit e shërbimeve të medias që synojnë publikun në territoret e tyre, por që janë themeluar në Shtete të tjera Anëtare, të japin kesi kontributesh financiare, të cilat duhet të jenë proporcionale dhe jodiskriminuese.
3. Në rastin e pikës 2, kontributi financiar do të bazohet vetëm në të ardhurat e fituara në shtetet anëtare marrëse të shërbimeve. Nëse shteti anëtar ku ofruesi është themeluar kërkon një kontribut të tillë financiar, ai do të marrë parasysh çdo kontribut financiar të kërkuar nga shtetet anëtare marrëse të shërbimeve. Çdo kontribut financiar duhet të jetë në përputhje me të drejtën e Bashkimit, në veçanti me rregullat në fushën e ndihmës shtetërore.
4. Brenda datës 19 dhjetor 2021 dhe, më pas, çdo dy vjet, shtetet anëtare do t'i raportojnë Komisionit për zbatimin e pikave 1 dhe 2.
5. Në bazë të informacionit të dhënë nga shtetet anëtare dhe të një studimi të pavarur, Komisioni i raporton Parlamentit dhe Këshillit Evropian për zbatimin e pikave 1 dhe 2, duke marrë parasysh zhvillimin e tregut dhe zhvillimin teknologjik, si dhe objektivin e diversitetit kulturor.
6. Detyrimi i vendosur sipas pikës 1 dhe kërkesa për ofruesit e shërbimeve të medias që synojnë të kapin publikun e Shteteve të tjera anëtare të përcaktuara në pikën 2, nuk do të zbatohen për ofruesit e shërbimit të medias me xhiro të ulët ose publik të ulët. Shtetet anëtare mund të heqin dorë gjithashtu nga këto detyrime ose kërkesa kur janë të pazbatueshme ose të pajustificuara për shkak të natyrës ose objektit të shërbimeve të medias audiovizive.

7. Pas konsultimit me Komitetin e Kontaktit, Komisioni do të nxjerrë udhëzime në lidhje me përlogaritjen e pjesës së veprave evropiane të përmendura në pikën 1 dhe në lidhje me përcaktimin e publikut të ulët dhe xhiros së ulët të përmendura në pikën 6.

## KAPITULLI V

### **DISPOZITA NË LIDHJE ME TË DREJTAT EKSKLUZIVE DHE KRONIKAT E SHKURTUARA NË TRANSMETIMET TELEVIZIVE**

#### *Neni 14*

1. Çdo shtet anëtar mund të marrë masa në përputhje me të drejtën e Bashkimit për të siguruar që transmetuesit nën juridiksionin e tij të mos transmetojnë në mënyrë ekskluzive ngjarje që ai shtet anëtar i konsideron të një rëndësie të madhe për shoqërinë në mënyrë që privon një pjesë të konsiderueshme të publikut në atë shtet anëtar nga mundësia për të ndjekur ngjarje të tilla në transmetim të drejtpërdrejtë ose të regjistruar në kanale falas.

Në këtë rast, shteti anëtar në fjalë do të hartojë një listë të ngjarjeve të caktuara, kombëtare ose jo kombëtare, që ai çmon me rëndësi të madhe për shoqërinë. Ato do të parashikohen në një mënyrë të qartë dhe transparente në kohën e duhur. Në këtë rast, shteti anëtar në fjalë do të përcaktojë gjithashtu nëse këto ngjarje duhet të ofrohen me transmetim të drejtpërdrejtë të plotë ose të pjesshme ose, kur është e nevojshme ose e përshtatshme për arsye objektive në interes të publikut, me transmetim të regjistruar të plotë ose të pjesshme.

2. Shtetet anëtare do të njoftojnë menjëherë Komisionin për masat e marra ose që do të merren sipas pikës 1. Brenda 3 muajsh nga njoftimi, Komisioni verifikon nëse këto masa janë në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe jua komunikon ato Shteteve të tjera anëtare. Ai do të kërkojë mendimin e Komitetit të Kontaktit të themeluar sipas nenit 29. Ai do të publikojë menjëherë masat e marra në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, dhe të paktën një herë në vit, publikon listën e konsoliduar të masave të marra nga shtetet anëtare.
3. Shtetet anëtare do të sigurojnë me mjete të përshtatshme brenda kuadrit të legjislacionit të tyre, që transmetuesit nën juridiksionin e tyre të mos ushtrojnë të drejta ekskluzive që ata kanë blerë pas datës 30 korrik 1997 në mënyra që privojnë një pjesë të konsiderueshme të publikut në një Shtet tjetër anëtar nga mundësia për të ndjekur ngjarjet e përcaktuara nga shteti tjetër anëtar sipas pikave 1 dhe 2 me transmetim të drejtpërdrejtë të plotë ose të pjesshëm ose, kur është e nevojshme ose e përshtatshme për arsye objektive në interes të publikut, me transmetim të regjistruar të plotë ose të pjesshëm të ofruar në televizion falas, siç përcaktohet nga ai Shtet tjetër Anëtar sipas pikës 1.

#### *Neni 15*

1. Me qëllim hartimin e kronikave të shkurtra të lajmeve, shtetet anëtare do të sigurojnë që çdo transmetues i themeluar në Bashkim të ketë qasje në kushte të barabarta, të



arsyeshme dhe jodiskriminuese në ngjarje me interes të lartë për publikun, të cilat transmetohen në mënyrë ekskluzive nga një transmetues nën juridiksionin e tyre.

2. Nëse një transmetues tjetër, i themeluar në të njëjtin shtet anëtar me transmetuesin që kërkon qasje, ka fituar të drejta ekskluzive për ngjarjen me interes të lartë për publikun, qasja do të kërkohej tek ai transmetues.
3. Shtetet anëtare duhet të garantojnë që kjo qasje të garantohet duke i lejuar transmetuesit të zgjedhë lirisht ekstrakte të shkurtra nga sinjali i subjektit transmetues, përveç kur është praktikisht e pamundur, me kusht që të paktën burimi i tyre të jetë i identifikuar.
4. Si alternativë e pikës 3, shtetet anëtare mund të krijojnë një sistem ekuivalent i cili mundëson qasje në kushte të barabarta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese me metoda të tjera.
5. Ekstraktet e shkurtra do të përdoren vetëm për programet e lajmeve me karakter të përgjithshme dhe mund të përdoren në shërbimet e medias audiovizive me kërkesë, vetëm nëse i njëjti program ofrohet në transmetim të regjistruar nga i njëjti ofrues i shërbimit të medias.
6. Pa cenuar pikat 1 deri 5, shtetet anëtare do të garantojnë, në përputhje me sistemet dhe praktikatat e tyre juridike, që mënyrat dhe kushtet që lidhen me ofrimin e këtyre ekstrakteve të shkurtra të jenë të përcaktuara, në veçanti, për sa i takon çdo ujdje për kompensim, kohëzgjatjes maksimale të ekstrakteve të shkurtra, si dhe afateve kohore të transmetimit të tyre. Nëse parashikohet kompensim, ai nuk do të tejkalojë kostot shtesë drejtpërdrejt të kryera për ofrimin e qasjes.

## KAPITULLI VI

### **PROMOVIMI I SHPËRNDARJES DHE PRODHIMIT TË PROGRAMEVE TELEVIZIVE**

#### *Neni 16*

1. Shtetet anëtare, kurdoherë që është e mundur dhe me përdorimin e mjeteve të përshtatshme, do të sigurojnë që transmetuesit të rezervojnë për veprat evropiane shumicën e kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshtitjes. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e transmetuesit ndaj publikut për çështje të informimit, edukimit, kulturës dhe argëtimit, kjo pjesë duhet të arrihet në mënyrë progresive, mbi bazën e kritereve të përshtatshme.
2. Nëse pjesa e kohës e caktuar në pikën 1 nuk mund të arrihet, ajo nuk duhet të jetë më e ulët se mesatarja e vitit 1988 në shtetin anëtar në fjalë. Megjithatë, për sa i takon Greqisë dhe Portugalisë, viti 1988 do të zëvendësohet me vitin 1990.

3. Çdo 2 vjet, duke filluar nga data 3 tetor 1991, shtetet anëtare do t'i dërgojnë Komisionit një raport mbi zbatimin e këtij neni dhe nenit 17.

Ky raport do të përmbajë në veçanti një tablo statistikore për arritjen e pjesës së kohës së referuar në këtë nen dhe nenin 17, për secilin prej programeve televizive nën juridiksionin e shtetit anëtar në fjalë, dhe në secilin rast, arsyet që çuan në mosarritjen e asaj pjese të kohës dhe masat e miratuara apo të parashikuara për ta arritur atë.

Komisioni do të informojë shtetet e tjera anëtare dhe Parlamentin Evropian mbi raportet, të cilat, kur është e përshtatshme, do të shoqërohen me një mendim. Komisioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij neni dhe të nenit 17 në përputhje me dispozitat e Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Komisioni, në mendimin e tij, mund të marrë parasysh, në veçanti, progresin e arritur krahasuar me vitet e mëparshme, pjesën e kohës që zënë në programim veprat e transmetuara për herë të parë, rrethanat e veçanta të transmetuesve të rinj televiziv, si dhe situatën specifike të vendeve me kapacitet të ulët të prodhimit audioviziv ose me një zonë gjuhësore të kufizuar.

#### *Neni 17*

Shtetet anëtare, kurdoherë që është e mundur dhe me përdorimin e mjeteve të përshtatshme, do të sigurojnë që transmetuesit të rezervojnë për veprat evropiane të krijuara nga prodhues të pavarur nga transmetuesit të paktën 10% të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshitjes, ose ndryshe, në zgjedhjen e shtetit anëtar, të paktën 10% të buxhetit të tyre të programimit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e transmetuesit ndaj publikut për çështje të informimit, edukimit, kulturës dhe argëtimit, kjo pjesë duhet të arrihet në mënyrë progresive, mbi bazën e kritereve të përshtatshme. Ajo duhet të arrihet duke caktuar një kuotë të përshtatshme për veprat e kohëve të fundit, që do të thotë veprat e transmetuara brenda 5 viteve të prodhimit të tyre.

#### *Neni 18*

Ky kapitull nuk do të zbatohet për transmetimet televizive që i drejtohen publikut vendas dhe që nuk janë pjesë e një rrjeti kombëtar.

## KAPITULLI VII

### **REKLAMAT TELEVIZIVE DHE TELESHTITJA**

#### *Neni 19*

1. Reklamat televizive dhe teleshitja duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme dhe të dallueshme nga përmbajtja editoriale. Pa cenuar përdorimin e teknikave të reja të reklamimit, reklama televizive dhe teleshitja duhet të jenë mjaft të dallueshme nga pjesa tjetër e programit me mjete optike dhe/ose akustike dhe/ose hapësinore.
2. Spotet e izoluara të reklamave televizive dhe teleshitjes janë të lejuara në ngjarjet sportive. Spotet e izoluara të reklamave televizive dhe teleshitjes, përveçse kur vendosen në transmetimet e ngjarjeve sportive, përbëjnë përjashtim.

#### *Neni 20*

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë që, nëse gjatë programeve futen reklama televizive ose teleshitje, nuk do të cenohen integriteti i programeve, duke marrë parasysh ndërprerjet e natyrshme, kohëzgjatjen, dhe natyrën e programit në fjalë, si dhe të drejtat e mbajtësve të tyre.
2. Transmetimi i filmave të bëra për televizion (me përjashtim të serive, serialeve dhe dokumentarëve), i veprave kinematografike dhe programeve të lajmeve mund të ndërpritet nga reklamat televizive, teleshitja, ose që të dyja, një herë për çdo periudhë të planifikuar pas të paktën 30 minutash. Transmetimi i programeve për fëmijë mund të ndërpritet nga reklamat televizive një herë për çdo periudhë të planifikuar pas të paktën 30 minutash, me kusht që kohëzgjatja e planifikuar e programit të jetë më e madhe se 30 minuta. Gjatë programeve për fëmijë është e ndaluar transmetimi i teleshitjeve. Gjatë shërbesave fetare, nuk do të futen as reklama televizive dhe as teleshitja.

#### *Neni 21*

Teleshitja e produkteve mjekësore për të cilat duhet autorizim për tregtimin, sipas kuptimit të Direktivës 2001/83/KE, si dhe teleshitja e trajtimeve mjekësore janë të ndaluara.

#### *Neni 22*

Reklamat televizive dhe teleshitja e pijeve alkoolike duhet të respektojnë kriteret e mëposhtme:

- (a) nuk duhet t'i drejtohet veçanërisht të miturve ose të paraqesë, në veçanti, të mitur që konsumojnë këto pije;
- (b) nuk duhet të lidhë konsumin e alkoolit me performancë më të lartë fizike ose me drejtimin e automjeteve;
- (c) nuk duhet të krijojë përshtypjen se konsumimi i alkoolit kontribuon në suksesin social ose seksual;
- (d) nuk duhet të nxisë besimin se alkooli ka cilësi terapeutike ose është nxitës, qetësues ose kontribuon në zgjidhjen e konflikteve personale;
- (e) nuk duhet të inkurajojë konsumimin e tepruar të alkoolit ose të paraqesë nën një dritë negative heqjen dorë nga konsumi i alkoolit ose të vetëpërmbajtjes;
- (f) nuk duhet të theksojë përmbajtjen e lartë alkoolike si një cilësi pozitive të pijeve.

#### *Neni 23*

1. Përqindja e spoteve të reklamave televizive dhe spoteve të teleshitjes, brenda fashës kohore nga ora 6:00 deri në orën 18:00, nuk duhet të tejkalojë 20% të kësaj fashe. Përqindja e spoteve të reklamave televizive dhe spoteve të teleshitjes, brenda fashës kohore nga ora 18:00 deri në orën 24:00, nuk duhet të tejkalojë 20% të kësaj fashe.
2. Pika 1 nuk zbatohet për:
  - (a) njoftimet e bëra nga transmetuesi në lidhje me programet e veta dhe produktet ndihmëse që rrjedhin drejtpërsëdrejti nga këto programe, ose në lidhje me programe dhe shërbime të medias audiovizive nga subjekte të tjera që i përkasin të njëjtit grup transmetues;
  - (b) njoftimet e sponsorizimit;
  - (c) vendosjet e produkteve;
  - (d) kornizat neutrale mes përmbajtjes editoriale dhe spoteve të reklamave televizive ose të teleshitjes, dhe spoteve individuale.

#### *Neni 24*

Dritaret e teleshitjes duhet të jenë qartësisht të identifikueshme si të tilla me mjete optike dhe akustike, si dhe duhet të kenë një kohëzgjatje minimale të pandërprerë prej 15 minutash.

#### *Neni 25*

Kjo direktivë zbatohet *mutatis mutandis* për kanalet televizive të dedikuara ekskluzivisht për reklamim dhe teleshitje, si dhe për kanalet televizive të dedikuara ekskluzivisht për vetë-promovim.

Megjithatë, Kapitulli VI, si dhe nenet 20 dhe 23, nuk do të zbatohen për këto kanale.

#### *Neni 26*

Pa cenuar nenin 4, shtetet anëtare mund, duke respektuar të drejtën e Bashkimit, të përcaktojnë kushte të ndryshme nga ato të nenit 20 (2) dhe nenit 23, në lidhje me transmetimet televizive të dedikuara vetëm për territorin kombëtar që nuk mund të merren drejtpërdrejt ose tërthorazi nga publiku në një ose më shumë shtete të tjera anëtare.

### **KAPITULLI IX E DREJTA E REPLIKËS NË TRANSMETIMET TELEVIZIVE**

#### *Neni 28*

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të ligjit civil, administrative ose penale të miratuar nga shtetet anëtare, çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nga kombësia, interesat legjitime të të cilit, në veçanti reputacioni dhe emri i mirë, janë dëmtuar nga një pohim i fakteve jo të sakta në një program televiziv, duhet të ketë të drejtën e replikës ose të mjeteve të barasvlershme me të.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që ushtrimi efektiv i së drejtës së replikës ose i mjeteve të barasvlershme me të të mos pengohet nga vendosja e kushteve ose afateve të paarsyeshme. Replika do të transmetohet brenda një kohe të arsyeshme pas kërkesës së argumentuar, si dhe brenda një orari dhe mënyre të përshtatshme për transmetim, të cilat citohen në kërkesë.

2. E drejta e replikës ose e mjeteve të barasvlershme me të do të zbatohet për të gjithë transmetuesit nën juridiksionin e një shteti anëtar.
3. Shtetet anëtare do të miratojnë masat e nevojshme për të krijuar të drejtën e replikës ose të mjeteve të barasvlershme me të, si dhe do të përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur për ushtrimin e tyre. Në veçanti, ato do të sigurojnë që afati i parashikuar për ushtrimin e të drejtës të jetë i mjaftueshëm dhe se procedurat të jenë të atilla që të lejojnë personat fizikë ose juridikë rezident ose të themeluara në një shtet tjetër anëtar të ushtrojnë siç duhet këtë të drejtë ose mjetet e barasvlershme me të.
4. Kërkesa për ushtrimin e të drejtës së replikës ose të mjeteve të barasvlershme me të mund të refuzohet, nëse kjo replikë nuk është e justifikuar sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, mund të përbëjë një akt të dënueshëm, mund ta bëjë transmetuesin të mbajë përgjegjësi civile ose mund të shkel standardet e mirësjelljes publike.

5. Do të hartohen dispozita për procedurat e shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjeve që lidhen me ushtrimin e të drejtës së replikës apo mjeteve të barasvlershme me të.

## KAPITULLI IXA

### **DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E SHËRBIMEVE TË OFRIMIT TË PLATFORMËS PËR SHPËRNDARJEN E VIDEOVE**

#### *Neni 28a*

1. Për qëllime të kësaj Direktive, ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove, i themeluar në territorin e një shteti anëtar, sipas kuptimit të nenit 3 (1) të Direktivës 2000/31/KE, është nën juridiksionin e atij shteti anëtar.
2. Ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove që nuk është themeluar në territorin e një shteti anëtar, sipas pikës 1, do të konsiderohet si i themeluar në territorin e një shteti anëtar për qëllimet e kësaj Direktive, nëse ai ofrues i platformës për shpërndarjen e videove:
  - (a) ka një shoqëri mëmë ose bijë të themeluar në territorin e atij shteti anëtar; ose
  - (b) është pjesë e një grupi dhe një shoqëri tjetër e këtij grupi në fjalë është themeluar në territorin e atij shteti anëtar.

Për qëllime të këtij neni:

- (a) “Shoqëri mëmë” është një shoqëri e cila kontrollon një ose më shumë shoqëri bija;
  - (b) “Shoqëri bijë” është një shoqëri e kontrolluar nga një shoqëri mëmë, përfshirë çdo degë të shoqërisë mëmë kryesuese të grupit;
  - (c) “Grup” është një shoqëri mëmë, të gjitha shoqëritë e saj bija dhe të gjitha shoqëritë e tjera që kanë lidhje ekonomike, ligjore dhe organizative me to.
3. Për qëllime të zbatimit të pikës 2, në rast se shoqëria mëmë, shoqëria bijë ose shoqëri të tjera të grupit janë themeluar secila në Shtete të ndryshme Anëtare, ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar ku është themeluar shoqëria e tij mëmë ose, në mungesë të një themelimi të tillë, në shtetin anëtar ku është themeluar shoqëria e tij bijë ose, në mungesë të një themelimi të tillë, në shtetin anëtar ku është themeluar shoqëria tjetër e grupit.
  4. Për qëllime të zbatimit të pikës 3, në rast se ka disa shoqëri bija dhe secila prej tyre është themeluar në një shtet anëtar të ndryshëm, ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar ku njëra nga shoqëritë bija ka nisur fillimisht veprimtarinë e saj, me kusht që të mbajë një lidhje të qëndrueshme dhe efektive me ekonominë e atij shteti anëtar.

Në rast se ka disa shoqëri të tjera të ndryshme që janë pjesë e grupit dhe secila prej tyre është themeluar në një shtet anëtar të ndryshëm nga tjetra, ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove do të konsiderohet si i themeluar në shtetin anëtar ku një prej këtyre shoqërive ka nisur fillimisht veprimtarinë e saj, me kusht që të mbajë një lidhje të qëndrueshme dhe efektive me ekonominë e atij shteti anëtar.

5. Për qëllime të kësaj Direktive, për ofruesit e platformës për shpërndarjen e videove që konsiderohen si të themeluar në një shtet anëtar, sipas pikës 2 të këtij neni, do të zbatohen neni 3 dhe nenet 12 deri 15 të Direktivës 2000/31/KE.
6. Shtetet anëtare do të krijojnë dhe mbajnë një listë të përditësuar të ofruesve të platformave për shpërndarjen e videove, të themeluar ose që konsiderohen si të themeluar në territorin e tyre dhe të përcaktojnë se mbi cilat prej kriterëve të pikave 1 deri në 4 bazohet juridiksioni i tyre. Këtë listë, shtetet anëtare ia bëjnë me dije Komisionit, përfshirë çdo përditësim të saj.

Komisioni do të sigurojë që këto lista të vihen në dispozicion në një bazë të dhënash të centralizuar. Në rast mospërputhje mes listave, Komisioni do të kontaktojë shtetet anëtare përkatëse për të gjetur një zgjidhje. Komisioni siguron që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të kenë qasje në këtë bazë të dhënash. Komisioni do të vendosë informacionin e bazës së të dhënave në dispozicion të publikut.

7. Nëse, në zbatim të këtij neni, shtetet anëtare të interesuara nuk bien dakord se cili shtet anëtar ka juridiksion, çështja do t'i dërgohet menjëherë Komisionit. Komisioni mund t'i kërkojë GERSHAV-it të japë një mendim për këtë çështje, në përputhje me shkronjën (d) të nenit 30b (3). GERSHAV-i jep mendim brenda 15 ditë pune nga marrja e kërkesës së Komisionit. Komisioni do të informojë rregullisht Komitetin e Kontaktit.

#### *Neni 28b*

1. Pa cenuar zbatimin e neneve 12 deri 15 të Direktivës 2000/31/KE, shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e platformës për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e tyre të marrin masat e duhura për të mbrojtur:
  - (a) të mitur nga programet, videot e krijuara nga publiku dhe komunikimet audiovizive tregtare, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, sipas nenit 6a (1);
  - (b) publikun në përgjithësi nga programet, videot e krijuara nga publiku dhe komunikimet audiovizive tregtare, të cilat nxisin dhunës ose urrejtjen kundrejt një grupi personash ose një anëtari të një grupi mbi bazën e një prej shkaqeve të parashikuara në nenin 21 të Kartës;
  - (c) publikun e gjerë nga programet, videot e krijuara nga publiku dhe komunikimet audiovizive tregtare që kanë përmbajtje, përhapja e të cilave përbën vepër penale sipas të drejtës së Bashkimit, konkretisht, provokimin e publikut për të kryer vepra penale terroriste sipas nenit 5 të Direktivës (BE) 2017/541, vepra penale të pornografisë me të mitur, sipas nenit 5(4) të Direktivës 2011/93/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian ([1](#)), dhe vepra penale që lidhen me racizmin dhe ksenofobinë, sipas nenit 1 të Vendimit Kuadër 2008/913/JHA.
2. Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e platformës për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e tyre të respektojnë kërkesat e nenit 9(1), në lidhje me komunikimet audiovizive tregtare që tregtohen, shiten ose organizohen nga këta ofrues.

Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e platformave për shpërndarjen e videove që janë nën juridiksionin e tyre të marrin masat e duhura për të respektuar kërkesat e nenit

9(1), në lidhje me komunikimet audiovizive tregtare që tregtohen, shiten ose organizohen nga këta ofrues, duke marrë parasysh kontrollin e kufizuar që këto platforma për shpërndarjen e videove ushtrojnë mbi këto komunikime audiovizive tregtare.

Shtetet anëtare do të sigurojnë që ofruesit e platformës për shpërndarjen e videove të informojnë qartësisht përdoruesit, kur programet dhe videot e krijuara nga publiku përmbajnë komunikime audiovizive tregtare, me kusht që këto komunikime të deklarohen sipas shkronjës (c), nënparagrafi i tretë, i pikës 3, ose ofruesi të ketë dijeni mbi këtë fakt.

Shtetet anëtare do të inkurajojnë përdorimin e rregulloreve të përbashkëta dhe do të nxisin vetë-rregullimin përmes kodeve të sjelljes, siç parashikohet në nenin 4a (1) duke synuar zvogëlimin në mënyrë të efektshme të ekspozimit të fëmijëve ndaj komunikimeve audiovizive tregtare për ushqime dhe pije që përmbajnë lëndë ushqyese dhe substanca me ndikim ushqyes ose fiziologjik, veçanërisht yndyra, acide trans-yndyrore, kripë ose natrium dhe sheqerna, marrja me tepri e të cilave nuk rekomandohet në dietën e përgjithshme. Këto kode synojnë të sigurojnë që këto komunikime audiovizive tregtare të mos vendosin theksin te cilësia pozitive e aspekteve ushqyese të këtyre ushqimeve dhe pijeve.

3. Për qëllime të pikave 1 dhe 2, masat e përshtatshme do të përcaktohen duke marrë parasysh natyrën e përmbajtjes në fjalë, dëmin që mund të shkaktojë, karakteristikat e kategorisë së personave që duhet të mbrohen, si dhe të drejtat dhe interesat legjitime, përfshirë edhe ato të ofruesve të platformës për shpërndarjen e videove dhe të përdoruesve që kanë krijuar ose ngarkuar përmbajtjen, si dhe interesin e përgjithshëm publik.

Shtetet anëtare do të sigurojnë që të gjithë ofruesit e platformave për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e tyre t'i zbatojnë këto masa. Këto masa duhet të jenë praktike dhe proporcionale, duke marrë parasysh madhësinë e shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove dhe natyrën e shërbimit që ofrohet. Këto masa nuk do të çojnë në masat e kontrollit paraprak (ex-ante) ose në filtrimin e përmbajtjeve në momentin e ngarkimit të tyre, kur nuk janë në përputhje me nenin 15 të Direktivës 2000/31/KE. Me qëllim mbrojtjen e të miturve, sipas shkronjës (a), pika 1, e këtij neni, përmbajtja më e dëmshme do t'i nënshtrohet masave më të rrepta të kontrollit të qasjes.

Sipas rastit, këto masa do të kërkojnë që:

- (a) në kushtet dhe afatet e platformës për shpërndarjen e videos të përfshihen dhe zbatohen kërkesat e pikës 1;
- (b) në kushtet dhe afatet e platformës për shpërndarjen e videos të përfshihen dhe zbatohen kërkesat e nenit 9 (1), në lidhje me komunikimet audiovizive tregtare që tregtohen, shiten ose organizohen nga këta ofrues të platformës për shpërndarjen e videove;
- (c) për përdoruesit që ngarkojnë video të krijuara nga publiku të jetë një funksion që i mundëson ata të deklarojnë nëse këto video përmbajnë komunikime audiovizive tregtare për aq sa ata janë në dijeni ose mund të pretendohet në mënyrë të arsyeshme se janë në dijeni;
- (d) të krijohen dhe vihen në funksion mekanizma transparente dhe të përdorshme për përdoruesit e një platforme për ndarjen e videove, me anë të cilave ata mund të

raportojnë ose sinjalizojnë ofruesin e platformës për përmbajtjen e cituar në pikën 1, të ofruar në platformën e tij;

- (e) të krijohen dhe vihen në operim sisteme me anë të të cilave ofruesit e platformave për shpërndarjen e videove iu shpjegojnë përdoruesve të këtyre platformave se çfarë ndikimi kanë raportimi dhe sinjalizimi i përmendur në shkronjën (d);
- (f) të krijohen dhe vihen në operim sisteme për verifikimin e moshës së përdoruesit të platformave për shpërndarjen e videove, në lidhje me përmbajtje që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve;
- (g) të krijohen dhe vihen në operim sisteme të lehta në përdorim, të cilat i lejojnë përdoruesit e platformave për shpërndarjen e videove të vlerësojnë përmbajtjen e përmendur në pikën 1;
- (h) të ofrohen sisteme të kontrollit prindëror, të cilat janë nën kontrollin e përdoruesit fundor, në lidhje me përmbajtje që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve;
- (i) të krijohen dhe vihen në funksion procedura transparente, të lehta në përdorim dhe të efektshme për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve kundër ofruesve të platformës për shpërndarjen e videove, në lidhje me zbatimin e masave të përmendura në shkronjat (d) deri (h);
- (j) të ofrohen masave dhe mjete efektive për edukimin e medias dhe rritjen e ndërgjegjësimit të përdoruesve për këto masa dhe mjete.

Të dhënat personale të të miturve të mbledhura apo ndryshe të nxjerra nga ofruesit e platformave për shpërndarjen e videove sipas shkronjave (f) dhe (h) të nënparagrafit të tretë nuk do të përpunohen për qëllime tregtare, të tilla si marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe reklamimi mbi bazë sjellje.

4. Për qëllime të zbatimit të masave të përmendura në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, shtetet anëtare do të inkurajojnë përdorimin rregulloreve të përbashkëta, siç parashikohet në nenin 4a (1).
5. Shtetet anëtare do të krijojnë mekanizmat e nevojshëm për të vlerësuar përshtatshmërinë e masave të parashikuara në pikën 3, të marra nga ofruesit e platformave për shpërndarjen e videove. Shtetet anëtare ia autoriteteve ose organeve rregullatore kombëtare vlerësimin e këtyre masave.
6. Shtetet Anëtare mund të vendosin masa më të hollësishme ose më të rrepta se masat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, për ofruesit e platformës për shpërndarjen e videove. Kur miratojnë këto masa, shtetet anëtare duhet të respektojnë kërkesat e përcaktuara nga ligji i aplikueshëm i Bashkimit, të tilla si ato të përcaktuara në nenet 12 deri 15 të Direktivës 2000/31/KE ose nenin 25 të Direktivës 2011/93/BE.
7. Shtetet anëtare do të garantojnë ofrimin e mjeteve juridike të zgjidhjes jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve mes përdoruesve dhe ofruesve të platformave për shpërndarjen e videove, në zbatim të pikave 1 dhe 3. Këto mekanizma mundësojnë zgjidhjen në mënyrë të paanshme të mosmarrëveshjeve dhe nuk do të zhveshin përdoruesit nga mbrojtja ligjore e garantuar nga ligji kombëtar.



8. Shtetet anëtare do të garantojnë që përdoruesit të ushtrojnë të drejtat e tyre para një gjykate, në lidhje me ofruesit e platformës për shpërndarjen e videove sipas pikave 1 dhe 3.
9. Komisioni inkurajon ofruesit e platformave për shpërndarjen e videove të shkëmbejnë praktikatat më të mira në lidhje me kodet e sjelljes për rregulloret e përbashkëta të përmendura në pikën 4.
10. Shtetet anëtare dhe Komisioni mund të nxisin vetë-rregullimin me anë të kodeve të sjelljes të Bashkimit, sipas nenit 4a (2).

## KAPITULLI X KOMITETI I KONTAKTIT

### *Neni 29*

1. Komiteti i Kontaktit do të krijohet nën kujdesin e Komisionit. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të shteteve anëtare. Do të kryesohet nga një përfaqësues i Komisionit dhe do të mblidhet me iniciativën e vetë ose me kërkesë të delegacionit të një shteti anëtar.
2. Detyrat e Komitetit të Kontaktit janë:
  - (a) të lehtësojë zbatimin efektiv të kësaj Direktive përmes konsultimeve të rregullta për çdo problem praktik që mund të lindë nga zbatimi i saj dhe, në veçanti, nga zbatimi i nenit 2, si dhe për çdo çështje tjetër për të cilën çmohet e dobishme shkëmbimi i mendimeve;
  - (b) të japë mendime me iniciativën e vetë ose me kërkesë të Komisionit në lidhje me zbatimin e kësaj Direktive nga shtetet anëtare;
  - (c) të jetë një forum për shkëmbimin e mendimeve se cilat çështje do duhet të trajtohen në raportet që shtetet anëtare duhet të paraqesin në zbatim të nenit 16 (3), si dhe të vendosur mbi metodologjinë e tyre;
  - (d) të diskutojë rezultatet e konsultimeve të rregullta që Komisioni mban me përfaqësuesit e organizatave të transmetuesve, prodhuesve, konsumatorëve, prodhuesve, ofruesve të shërbimeve dhe sindikatave, si dhe komunitetin krijues;
  - (e) të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mes shteteve anëtare dhe Komisionit në lidhje me gjendjen dhe zhvillimin e aktiviteteve rregullatorë për shërbimet e medias audiovizive, duke marrë parasysh politikën audiovizive të Bashkimit, si dhe zhvillimet përkatëse në fushën teknike;
  - (f) të shqyrtojë çdo zhvillim të sektorit për të cilin është i dobishëm shkëmbimi i mendimeve.

## KAPITULLI XI

### **AUTORITETET DHE ORGANET RREGULLATORE TË shteteve anëtare**

### *Neni 30*

1. Çdo shtet anëtar do të caktojë një ose më shumë autoritete ose organe rregullatore kombëtare, ose që të dyja bashkë. Shtetet anëtare do të garantojnë mëvetësinë e tyre nga qeveria, si dhe pavarësinë funksionale nga qeveritë përkatëse si dhe nga cilido organ tjetër

publik ose privat. Këtu nuk do të cenohet mundësia e shteteve anëtare për të krijuar ente rregullatore që mbikëqyrin sektorë të ndryshëm.

2. Shtetet anëtare do të sigurojnë që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente si dhe në përputhje me objektivat e kësaj Direktive, në veçanti, pluralizmi i medias, diversiteti kulturor dhe gjuhësor, mbrojtja e konsumatorit, qasja, mosdiskriminimi, funksionimi i duhur i tregut të brendshëm dhe promovimi i konkurrencës së ndershme.

Autoritetet ose organet rregullatore kombëtare nuk duhet të kërkojnë ose marrin udhëzime nga asnjë organ tjetër në lidhje me ushtrimin e detyrave që iu janë caktuar sipas ligjit kombëtar, i cili zbaton ligjin e Bashkimit. Kjo nuk do të ndalojë mbikëqyrjen në përputhje me ligjin kombëtar kushtetues.

3. Shtetet anëtare do të garantojnë që funksionet dhe kompetencat e autoriteteve ose organeve rregullatore kombëtare, si dhe mënyrat për t'i bërë ata të përgjegjshëm, të përcaktohen qartazi në ligj.
4. Shtetet anëtare do të garantojnë që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të kenë burime financiare dhe njerëzore, dhe kompetenca ligj-zbatuese të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre në mënyrë të efektshme dhe për të kontribuar në punën e GERSHAV-it. Shtetet anëtare do të garantojnë që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të kenë buxhetet e tyre vjetore, të cilat do të bëhen publike.
5. Shtetet anëtare do të përcaktojnë në ligjin e tyre kombëtar kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të autoriteteve dhe organeve rregullatore kombëtare ose të anëtarëve të bordit kolegjal që kryen atë funksion, përfshirë edhe kohëzgjatjen e mandatit. Procedurat do të jenë transparente, jodiskriminuese dhe do të garantojnë shkallën e nevojshme të pavarësisë. Kreu i një autoriteti ose organi rregullator kombëtar, ose anëtarët e bordit kolegjal që kryen atë funksion, brenda një autoriteti ose organi rregullator kombëtar, mund të shkarkohen nëse nuk plotësojnë më kushtet e kërkuara për kryerjen e detyrave të tyre, të cilat janë parashikuar paraprakisht në nivel kombëtar. Vendimi për shkarkim do të argumentohet siç duhet, pasi të jetë njoftuar paraprak dhe të vihet në dispozicion të publikut.
6. Shtetet anëtare do të garantojnë që, në nivel kombëtar, të ekzistojnë mekanizma efektiv të ankimit. Organi i ankimit, që mund të jetë një gjykatë, do të jetë i pavarur nga palët e përfshira në ankim.

Në pritje të rezultatit të ankimit, mbetet në fuqi vendimi i autoritetit ose organit rregullator kombëtar, përveç kur jepen masa të përkohshme në përputhje me ligjin kombëtar.

#### *Neni 30a*

1. Shtetet anëtare do të garantojnë që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të marrin masat e nevojshme për të shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe me Komisionin informacionin e nevojshëm për zbatimin e kësaj Direktive, në veçanti nenet 2, 3 dhe 4.

2. Në kuadër të shkëmbimit të informacionit sipas pikës 1, kur autoritetet ose organet rregullatore kombëtare marrin informacion nga një ofrues i shërbimit të medias nën juridiksionin e tyre se do të ofrojë një shërbim, i cili i drejtohet tërësisht ose më së shumti publikut të një shteti tjetër anëtar, autoriteti ose organi rregullator kombëtar në shtetin anëtar që ka juridiksion do të informojë autoritetin ose organin rregullator kombëtar të shtetit anëtar të synuar.
3. Nëse autoriteti ose organi rregullator i një shteti anëtar, territori i të cilit synohet të arrihet nga një ofrues i shërbimit të medias nën juridiksionin e një shteti tjetër anëtar, i dërgon autoritetit ose organit rregullator të shtetit anëtar që ka juridiksion mbi të, një kërkesë në lidhje me aktivitetet e këtij ofruesi. Autoriteti ose organi rregullator i fundit do të bëjë ç'është e mundur për të trajtuar kërkesën brenda dy muajve, pa cenuar afate kohore më të rrepta të zbatueshme në sipas kësaj Direktive. Kur kërkohet, autoriteti ose organi rregullator i shtetit anëtar të synuar do t'i japë autoritetit ose organit rregullator të shtetit anëtar që ka juridiksion, çdo informacion që mund ta ndihmojë në trajtimin e kërkesës.

#### *Neni 30b*

1. Këtu themelohet Grupi kombëtar i Rregullatorëve të Shërbimeve të Medias Audiovizive (GERSHAV).
2. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve ose organeve rregullatore kombëtare në fushën e shërbimeve të medias audiovizive me përgjegjësi kryesore në mbikëqyrjen e shërbimeve të medias audiovizive, ose kur nuk ka autoritet ose organ rregullator kombëtar, nga përfaqësues të tjerë të zgjedhur sipas procedurave të tyre. Në mbledhjet e GERSHAV-it do të të marrë pjesë edhe një përfaqësuesi i Komisionit.
3. GERSHAV-i do të ketë këto detyra:
  - (a) do t'i ofrojë Komisionit ekspertizë teknike:
    - për të siguruar një zbatim koherent të kësaj Direktive në të gjitha shtetet anëtare,
    - në çështjet që lidhen me shërbimet e medias audiovizive brenda kompetencave të tij;
  - (b) do të shkëmbejë përvojën dhe praktikat më të mira për zbatimin e kuadrit rregullator për shërbimet e medias audiovizive, përfshirë edhe çështjen e qasjes dhe edukimit në media;
  - (c) do të bashkëpunojë dhe t'u ofrojë anëtarëve të saj informacionin e nevojshëm për zbatimin e kësaj Direktive, veçanërisht në lidhje me nenet 3, 4 dhe 7;
  - (d) do të japë mendime, me kërkesë të Komisionit, në lidhje me aspekte teknike dhe praktike të çështjeve të referuara në nenin 2 (5c), nenin 3 (2) dhe (3), shkronja (c) e nenit 4 (4) dhe nenit 28a (7).
4. GERSHAV-i do të miratojë rregullat e veta të procedurës.

## KAPITULLI XII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### *Neni 31*

Në fushat që nuk koordinohen nga kjo Direktivë, nuk do të ndikohen të drejtat dhe detyrimet e shteteve anëtare që rrjedhin nga konventat ekzistuese që kanë të bëjnë me telekomunikacionin ose transmetimin.

#### *Neni 32*

Shtetet anëtare do t'i dërgojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

#### *Neni 33*

Komisioni do të monitorojë zbatimin e kësaj Direktive nga shtetet anëtare.

Brenda datës 19 dhjetor 2022 dhe, më pas, çdo tre vjet, Komisioni do t'i paraqesë Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komitetit Ekonomik e Social Evropian, një raport mbi zbatimin e kësaj Direktive.

Së paku, brenda datës 19 dhjetor 2026, Komisioni do t'i paraqesë Parlamentit dhe Këshillit Evropian një vlerësim *ex post* të ndikimit të kësaj Direktive dhe vlerës së saj shtuar, të shoqëruar, nëse është e përshtatshme, me propozime për rishikim të saj.

Komisioni informon rregullisht Komitetin e Kontaktit dhe GERSHAV-in mbi punën dhe veprimtarinë e të tjerëve.

Komisioni do të garantojë që informacioni i marrë nga shtetet anëtare për çdo masë që ata kanë marrë në fushat e koordinuara nga kjo Direktivë t'i komunikohet Komitetit të Kontaktit dhe GERSHAV-it.

#### *Neni 33a*

1. Shtetet anëtare do të promovojnë dhe marrin masa për zhvillimin e edukimit në fushën e mediave.
2. Brenda datës 19 dhjetor 2022 dhe, më pas, çdo tre vjet, shtetet anëtare do t'i raportojnë Komisionit mbi zbatimin e pikës 1.
3. Pas konsultimit me Komitetin e Kontaktit, Komisioni do të nxjerrë udhëzime në lidhje me sferën e zbatimit të këtyre raporteve.

#### *Neni 34*

Direktiva 89/552/KEE, e ndryshuar nga Direktivat e renditura në Shtojcën I, Pjesa A, do të shfuqizohet, pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare që lidhen me afatet kohore për transpozimin e Direktivave të renditura në Aneksin I, Pjesa B, në ligjin kombëtar.

Çdo referim të Direktiva e shfuqizuar do të interpretohet si referim në këtë Direktivë dhe do të kuptohet në përputhje me tabelën e korrelacionit në Aneksin II.

#### *Neni 35*

Kjo Direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas publikimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

#### *Neni 36*

Kjo Direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

*SHTOJCA I*

**PJESA A**

Direktiva e shfuqizuar dhe lista e ndryshimeve pasuese  
(referuar në Nenin 34)

Direktiva e Këshillit 89/552/KEE (OJ L 298, 17.10.1989, f. 23)	
Direktiva 97/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 202, 30.7.1997, f. 60)	
Direktiva 2007/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 332, 18.12.2007, f. 27)	vetëm Neni 1

**PJESA B**

Lista e afateve kohore për përafrimin e legjislacionit kombëtar  
(referuar në Nenin 34)

<b>Direktiva</b>	<b>Afati kohor për përafrimin</b>
89/552/KEE	3 tetor 1991
97/36/KE	31 dhjetor 1998
2007/65/KE	19 dhjetor 2009

---

TABELA E NDËRLIDHJES

<b>Direktiva 89/552/KEE</b>	<b>Kjo Direktivë</b>
Neni 1, formulimi hyrës	Neni 1(1), formulimi hyrës
Neni 1(a), formulimi hyrës	Neni 1(1)(a), formulimi hyrës
Neni 1(a), kryeradha e parë	Neni 1(1)(a)(i)
Neni 1(a), kryeradha e dytë	Neni 1(1)(a)(ii)
Neni 1(b) - (m)	Neni 1(1)(b) - (m)
Neni 1(n)(i), formulimi hyrës	Neni 1(1)(n), formulimi hyrës
Neni 1(n)(i), kryeradha e parë	Neni 1(1)(n)(i)
Neni 1(n)(i), kryeradha e dytë	Neni 1(1)(n)(ii)
Neni 1(n)(i), kryeradha e tretë	Neni 1(1)(n)(iii)
Neni 1(n)(i), kryeradha e katërt	Neni 1(2)
Neni 1(n)(ii), formulimi hyrës	Neni 1(3), formulimi hyrës
Neni 1(n)(ii), kryeradha e parë	Neni 1(3)(i)
Neni 1(n)(ii), kryeradha e dytë	Neni 1(3)(ii)
Neni 1(n)(ii), kryeradha e tretë	Neni 1(3)(iii)
Neni 1(n)(iii)	Neni 1(4)
Neni 2	Neni 2
Neni 2a(1), (2) dhe (3)	Neni 3(1), (2) dhe (3)

Neni 2a(4), formulimi hyrës	Neni 3(4), formulimi hyrës
Neni 2a(4)(a)	Neni 3(4)(a)
Neni 2a(4)(b), formulimi hyrës	Neni 3(4)(b), formulimi hyrës
Neni 2a(4)(b), kryeradha e parë	Neni 3(4)(b)(i)
Neni 2a(4)(b), kryeradha e dytë	Neni 3(4)(b)(ii)
Neni 2a(5) dhe (6)	Neni 3(5) dhe (6)
Neni 3	Neni 4
Neni 3a	Neni 5
Neni 3b	Neni 6
Neni 3c	Neni 7
Neni 3d	Neni 8
Neni 3e	Neni 9
Neni 3f	Neni 10
Neni 3g(1)	Neni 11(2)
Neni 3g(2), nënpika 1, formulimi hyrës	Neni 11(3), nënpika 1, formulimi hyrës
Neni 3g(2), nënpika 1, kryeradha e parë	Neni 11(3), nënpika 1, pika (a)
Neni 3g(2), nënpika 1, kryeradha e dytë	Neni 11(3), nënpika 1, pika (b)
Neni 3g(2), nënpika 2, 3 dhe 4	Neni 11(3), nënpika 2, 3 dhe 4
Neni 3g(3)	Neni 11(4)
Neni 3g(4)	Neni 11(1)
Neni 3h	Neni 12
Neni 3i	Neni 13
Neni 3j	Neni 14

Neni 3k	Neni 15
Neni 4(1), (2) dhe (3)	Neni 16(1), (2) dhe (3)
Neni 4(4)	—
Neni 5	Neni 17
Neni 9	Neni 18
Neni 10	Neni 19
Neni 11	Neni 20
Neni 14	Neni 21
Neni 15	Neni 22
Neni 18	Neni 23
Neni 18a	Neni 24
Neni 19	Neni 25
Neni 20	Neni 26
Neni 22	Neni 27
Neni 23	Neni 28
Neni 23a	Neni 29
Neni 23b	Neni 30
Neni 24	Neni 31
—	Neni 32
Neni 26	Neni 33
—	Neni 34
—	Neni 35
Neni 27	Neni 36
—	Shtojca I
—	Shtojca II

---

([1](#)) Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, më 13 dhjetor 2011 për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA (OJ L 335, 17.12.2011, f. 1).